RAPORTI I

VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

(V.N.M.)

"FABRIKE PRODHIMI BETONI NE VENDIN E QUAJTUR LUZAT,BASHKIA TEPELENE,QARKU GJIROKASTER"

SUBJEKTI "DERVENI 1" SH.P.K.

AUTORE:EKSPERT MJEDISI : ING. FATMIR NUHAJ, NR.427 PROT, DT. 01.08.2007

VENDIMI NR.9, NR. 244 REGJ.

TIRANE,MAJ 2017

TABELA PERMBLEDHESE

1 TE PERGJITHSHME 3

1.1. HYRJE 3
1.2. TE DHENA TE PERGJITHSHME 4

2 PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL 5

2.1. TE PERGJITHSHME 5
2.2. LEGJISLACIONI 8
2.3. PERMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR 9
2.4. METODOLOGJIA 10

3 PERSHKRIM I PROJEKTIT 11

3.1. QELLIMI I PROJEKTIT 11
3.2. TE DHENA TEKNIKE TE AKTIVITETIT 11
3.3. VENDODHJA E OBJEKTIT 12
3.4. LIDHJA E OBJEKTIT ME INFRASTRUKTUREN INXHINIERIKE 13
3.5. PËRSHKRIMI I PROCESEVE TEKNOLOGJIKE TË PROJEKTIT 14
3.6. LLOJI, VOLUMI, KONSUMI DHE PRODHIMI I LËNDËVE TË PARA 14
3.7. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE 14
3.8. INFORMACION PËR SHKARKIMET NË MJEDIS 15

4 PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT 16

4.1. TE PERGJITHSHME 16
4.2. BURIMET UJORE NE ZONEN PERRETH 16
4.3. PROBLEMET KRYESORE TE ZONES SE TEPELENES 16
4.4. MJEDISI FIZIK 19
Gjeologjia, gjeomorfologjia 19
Biodiversiteti, flora dhe fauna 21
Flora dhe Fauna 21
Hidrografia 22
Trashegimia arkitektonike, arkeologjike dhe historike 25

5 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE RENDESISHME NE MJEDIS 28

5.1. NDIKIME TE RENDESISHME GJATE NDERTIMIT 28
5.1.1. Shkarkime ne uje 28
5.1.2. Emetimet ne ajer 28
5.1.3. Zhurmat dhe vibrimet 29
5.1.4. Ndikimi ne toke 29
5.1.5. Ndikimi ne flore/faune 29
5.1.6. Mbetjet e prodhuara 29
5.2. NDIKIME TE RENDESISHME GJATE FUNKSIONIMIT 30
5.2.1. Shkarkime ne uje 30
5.2.2. Emetimet ne ajer 30
5.2.3. Zhurmat dhe vibrimet 30
5.2.4. Mbetjet e prodhuara 30

6 MASAT KRYESORE LEHTESUESE 31

6.1. MASAT LEHTESUESE QE DO TE NDERMERREN GJATE NDERTIMIT DHE SHFRYTEZIMIT TE OBJEKTIT. 31

7 PROGRAMI MONITORIMIT 32

7.1. SKEMA E MONITORIMIT TE TREGUESVE MJEDISOR 32

8 REKOMANDIME 33

1 TE PERGJITHSHME

1.1. Hyrje

Vendi yne gjate viteve te fundit ka miratuar nje sere ligjesh dhe vendimesh te Keshillit te Ministrave ne fushen e mbrojtjes se mjedisit, duke permiresuar ndjeshem legjislacionin mjedisor dhe social ekonomik te vendit. Gjithashtu gjate kesaj periudhe Shqiperia ka nenshkruar edhe nje sere konventash dhe protokollesh ne klimen e permiresimit te cilesise mjedisore ne vend dhe rajon. Disa prej ketyre konventave te nenshkruara jane:

- Konventa e Aarhus per akses ne informacion, pjesemarrje te publikut ne vendim marrje ambjentaliste dhe akses te drejtesise ne ceshtjet ambjentaliste, te ratifikuar me Ligjin Nr. 8672, date 26 tetor 2000,
- Konventën e Rio De Janeiro-s per Biodiversitetin, te ratifikuar me 10 Nentor 1996,
- Konventa per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkufitar ESPOO, Finlandë, me 25 shkurt 1991
- Konventa mbi Ndotjen Atmosferike në distanca të mëdha, Gjenevë, Zvicër, me 13 nëntor 1979.
- Konventa për Ruajtjen e Florës dhe Faunes së egër dhe mjedisit natyror të Europës Ne Bernë, 19 shtator 1979. Etj.

Nenshkrimi i nje sere konventash dhe miratimi i kuadrit ligjor per mjedisin dhe ne funksion te tyre, detyron institucionet shteterore dhe subjektet fizike e juridike ti nenshtrohen disa procedurave profesionale para miratimit dhe zbatimit te projektit te tyre.
Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) eshte nje prej instrumentave parandalues dhe minimizues te ndikimit mjedisor dhe per projektin specifik, hartohet duke u bazuar ne zhvillimin strategjik te qytetit te Tepelenes dhe rrethinave perreth. Ky raport perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit te zbatimit te projektit te Fabrikes se Betonit e cila do sherbeje per prodhimin e betoneve te markave te ndryshme qe do te perdoret per ndertmin e rrugeve te ndryshme ne kete rajon.kjo Fabrike ndodhet prane rruges qendrore qe te con nga Tepelena ne Gjirokaster,me kerkese te Shoqerise"Derveni 1"sh.p.k, me perfaqesues ligjor **Z.Reshat Zika.**Objekti ne teresine e tij ka edhe sheshe parkimi, siperfaqe te gjelberuar, akses hyrje-dalje per mjetet e renda dhe te vogla, ambjente per administraten, etj.

1.2. Te dhena te pergjithshme

Shoqeria "DERVENI 1" sh.p.K me seli ne Tepelene ,filiali Tirane,e perfaqesuar nga Administratori dhe Ortaku I vetem Z.Reshat Zika,I regjistruar ne Gjykaten e Rrethit Tirane si Person Juridik,me Vendim Nr.34047 date 23.09.2005,e cila e ushtron aktivitetin e saj privat nepermjet certifikates Tatimore me NIPT. K49322548U.Per rifreskimin e Lejes Mjedisore Fabrike prodhimi Betoni ky project mjedisor do te paiset me te gjitha miratimet perkatese te lejeve te nevojshme.

Pamje satelitore e zones ne vleresim



Treguesit teknik te Projektit

PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

2.1. Te pergjithshme

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti ndertimor te caktuar. Ne nje situate normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimet dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit.

Por sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative ne mjedis dhe shendet te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te studimet e propozuara; dhe
- Te promovoje zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis.

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM-se ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje dokument kyç per vendimarrjen per miratimin e nje zhvillimi te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per Mjedisin dhe Zhvillimin. VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimmarrje te nje Autoriteti Kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori. Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar e konsiderueshme potenciale ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar. Qellimi afatgjate i VNM eshte te promovoje zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

1. Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
2. Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me efiçence;
3. Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projekt apo propozimit; dhe
4. Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projetit te propozuar.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;

- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale te projektit

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise kerkohet: ***"Mirembajtje e nje mjedisi teper te shendetshem dhe ekologjik per brezat e tanishem dhe te ardhshem"***. Kjo, por edhe opinioni i gjithe shoqerise i shprehur nepermejt ligjeve te tjera, detyron marrjen e masave imediate per rehabilitimin e mjedisit te degraduar gjate "epokes se industrializimit socialist" dhe ruajtjen e tij nga aktivitetet e sotme prodhuese, perpunuese apo ndertuese qe gjithashtu mund te shkaktojne demtime te mjedisit. Legjislacioni ne lidhje me ruatjen e mjedisit eshte ne perputhje me normativat Europiane te mbrojtjes se tij ndonese cilesia mjedisore eshte ende ne parametra mjaft te ulet, kjo edhe ne krahasim me vendet e tjera Europiane.

Ligji i pare per mbrojtjen mjedisore daton ne vitin 1993 dhe shprehet se: "Te gjitha veprimtarite e personave fizike dhe ligjore, vendas apo te huaj, qe ushtrojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise, do ti nenshtrohen vleresimeve mjedisore". Me tej, Ligji Nr. 8934, mbi mbrojtjen mjedisore percakton se: "Mbrojtja e mjedisit eshte detyrim i te gjithe shtetasve dhe individeve me veprimtari ne Shqiperi"

Ky raport hartohet mbi bazen e mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licensimin ose jo te aktiviteteve te ndryshme te cilat mund te kene potencial ndotes ne mjedis.

Sipas Ligjit Nr. 10431, date 09.06.2011. Per mbrojtjen e mjedisit, me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

Parimet e mbrojtjes së mjedisit

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"

- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrotjen e integruar te përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

Mbrojtja e Perberesve te mjedisit klasifikohet ne:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

2.2. Legjislacioni

Sa me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacionin mjedisor si me poshte dhe ka per qellim qe te identifikoje, parashikoje dhe parandaloje ndikimin e këtij aktiviteti ne mjedis.
Kuadri ligjor për VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri: "Ligji Per mbrojtjen e mjedisit" dhe "Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis". Keto ligje se fundmi jane perafruar plotesisht me ligjet e Bashkimit Europian per mbrojtjen e mjedisit.
Bazuar ne Ligjet e mbrojtjes se mjedisit, ky aktivitet klasifikohet per funksionimin e aktivitetit, Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

- VNM e Permbledhur
- VNM e Thelluar

Aktiviteti ne vleresim, ne baze te klasifikimit te tij si aktivitet me ndikim te vogel ne mjedis, klasifikohet si raport i permbledhur i VNM.
Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te veçante dhe te rendesishem te mjedisit. Keshtu, nder ligjet me specifike qe kane lidhje te drejtperdrejte me projektin ne vleresim, mund te permendim:

- Ne ligjin Nr. 10 431, date 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" theksohet ne kapitullin V (VNM) neni 25 se:

Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

- Ne Ligjin Nr.10 440, date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" ne kreun II, neni 7 per "Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis" thuhet:

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së dhe licencimi, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

a) Raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;

b) Raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis perfshin indentifikimin, saktesimin dhe vleresimin e drejtperdrejte dhe te terthorte te projektit ne mjedisin ku do te zbatohet, si dhe percaktimi i masave per te parandaluar dhe zbutur demtimet ne mjedis qe ne fazen fillestare te tij.

2.3. Permbledhje e kuadrit ligjor

Menaxhimi dhe mbrotja e mjedisit jane pjese e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) i kushtetutes shkruhet se: "Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve qe disponon, si dhe ne plotesimin e nismes dhe te pergjegjesise private, synon: Neni d): nje mjedis te shendetshem dhe ekologjikisht te pershtatshem per brezat e sotem dhe te ardhshem.

Sipas Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit", Ministria e Mjedisit eshte autoriteti pergjegjes per rishikimin e dokumentit VNM te pergatitur nga ekspertet e licensuar prej ministrise se mjedisit.

Pervec Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit", Parlamenti i Republikes se Shqiperise miratoi edhe Ligjin Nr. 10440 Date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis". Ky ligj eshte zhvilluar dhe bazuar ne Direktivat e EU dhe praktikat nderkombetare te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

Nder ligjet e tjera te legjislacionit kombetar ne lidhje me aktivitetin, këtë VNM dhe mjedisin përfshijnë:

- **Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"**
- **Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis"**
- **Ligji Nr 8652 Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore, dt 31.07.2000.**
- **Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"**
- **Ligj Nr. 10119 date 23.04.2009 "Per planifikimin e territorit"**

- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".**
- **Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të Mjedisit"**
- **Vendimi Nr.247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave"**
- **Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis".**
- **Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre".**
- **Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse".**
- **Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera"**
- **Vendim Nr. 16, date 14.01.2012 "Per te drejten e publikut per te pasur informacion mjedisor"**
- **Vendim Nr. 13, date 04.01.2013 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis"**
- **Udhezim Nr. 7938, datë 17.7.2014 "Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen ministria e mjedisit për procesin e VNM-së"**

2.4. Metodologjia

Per hartimin e raportit te VNM, porositesi vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit materialin teknik dhe juridik. Ky raport vleresimi pergatitet me kerkese te investitorit, shoqerise "DERVENI 1" sh.p.k. U kryen inspektime ne terren per te konstatuar vendodhjen, karakteristikat territoriale te kesaj zone, gjendja e faktoreve te mjedisit, si dhe per te terhequr mendimin e komunitetit te zones dhe zhvillimin e aktivitetit.

Tabela: 1: Kriteret e klasifikimit per procedurat shqiptare te VNM-se

Kategoria sipas Legjislacionit Shqiptar	**Procedura qe Duhet Ndjekur (Duke plotesuar Standartet Shqiptare)**
Aneksi i Ligjit 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit" (Lista e veprimtarive te cilat duhet te paisen me Leje Mjedisi te tipit A, B ose C)	Sipas kerkesave te ligjit Nr 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", Shtojca 1 per Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C ky aktivitet klasifikohet per paisje me leje mjedisore. Sipas konsultimeve me Drejtorine Rajonale te Mjedisit te Qarkut Gjirokaster dhe Agjencine Kombetare te Mjedisit, ky aktivitet duhet te ripaiset me leje mjedisi per fazen e funksionimit, pasi ti jete nenshtruar procedures paraprake te VNM-se. Projekti do ti nenshtrohet raportit dhe procedures paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis sipas kerkesave te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 Per VNM, Shtojca II, VKM Nr. 13, date 04.01.2013 Per VNM, si dhe kerkesave te NJ.Q.V.

3 PERSHKRIM I PROJEKTIT

3.1. Qellimi i projektit

Qëllimi i projektit eshte ripajisje me Leje Mjedisi I Fabrikes se Asfaltit te Shoqerise ndertuese "Derveni 1"me seli ne qytetin e Tepelenes dhe me Filial ne Tirane.Objekti eshte ndertuar ne perputhje me studimin e pergjithshem dhe me planin e detajuar te zhvillimit te territorit.

3.2. Te dhena teknike te aktivitetit

Subjekti ndertues "DERVENI 1" SH.P.K i regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, me Numer Identifikimi te Personit te Tatueshem: K49322548U,me seli ne Tepelene dhe Filial ne Tirane me administrator **Z.Reshat Zika** do te pajiset me Leje Mjedisore per Fabriken e prodhimit te asfaltit.Ky aktivitet ka krijuar mundesine e punesimit te dhjetra punetoreve ne kete kantjer.Vendi i përzgjedhur për këtë qëllim është i përshtatshëm pasi ndodhet larg qëndrave urbane dhe nga burimet ujore. Ai është pranë fshatit Vasjar ne vendin e quajtur Mogila dhe në një terren tepër të përshtatshëm dhe në pozicion te favorshem per tu lidhur me rruget urbane dhe interurbane.
Siperfaqja ne te cilen zhvillohet ky aktivitet eshte e lire nga ndertimet, nuk karakterizohet nga siperfaqe pyjore, eshte toke ndertimi, truall zallishte.

3.3. Vendodhja e objektit

Sheshi i cili do te sherbeje per zhvillimin e prodhimit te Fabrikes Betonit ka nje siperfaqe totale prej 4200 m2 dhe perbehet nga 1 parcele me Zone Kadastrale 2541 dhe Nr. Pasurie 77/5. Kjo prone eshte perkatesisht e llojit Zellishte dhe Truall. Sheshi pozicionohet ose ndodhet ne fshatin "Luzat", rreth 400 m larg nga rruga kryesore, në një zonë ku mbizotërojnë ndërtime të ngjashme të karakterit industrial apo prodhimit.

3.4. Lidhja e objektit me infrastrukturen Inxhinierike

Vendi i përzgjedhur për këtë qëllim, ne rrethinat e Tepelenes është i përshtatshëm pasi ndodhet larg qëndrave te medha urbane, i pershtatshem per funksioninn e destinuar dhe per punesim. Ai është afer me rrugen kryesore, dhe në një terren tepër të përshtatshëm dhe në pozicion te favorshem per tu lidhur me rruget urbane dhe interurbane.

Shenimet e formularit 3/1 vertetojne se zhvillimi i zones dhe ndertimi i ketij objekti me destinacion industrial, nuk do te ndikoje ne demtimin ose devijimin e infrastruktures inxhinierike ekzistuese. Deri ne ndertimin e nje sistemi te ri kanalizimesh per te gjithe zonen e studiuar, objekti do te plotesoje nevojat e tij per uje higjeno-sanitar nepermjet shfrytezimit te rrjetit ekzistues dhe persa i perkete sistemit te shkarkimit te ujerave te zeza, do te lidhen me kanalizimet ekzistuese ne zone sic jane ato te objekteve te ndertuara me heret.

Mbetjet e ngurta do te menaxhohen ne bashkepunim me Bashkine Tepelene dhe do te percaktohet vendi i depozitimit te tyre nga kjo e fundit, pasi te jete miratuar leja e zhvillimit. Ne kete faze te projektit nuk eshte percaktuar ende destinacioni i mbetjeve inerte. Pastrimi i mbetjeve urbane do te kryhet nepermjet vendosjes se koshave te mjaftueshem per aktivitetin dhe sherbimi i pastrimit te mbetjeve te ngurta urbane do te kryhet nga firma pastruese e zones, e cila i grumbullon keto mbetje ne Landfillin me te afert.

3.5. Përshkrimi i proceseve teknologjike të projektit

Proceset teknologjike ne kete projekt jane ato te fazes ndertimore, nepermjet punimeve te ndertimit te cilat do te kryhet nga firma ndertuese.

Disa prej proceseve kryesore te punimeve ndertimore qe jane kryer jane keto:

- Rrethimi i sheshit ku eshte vendosur Fabrika e prodhimit te betonit.
- Pastrimi i sheshit te ndertimit nga struktura te perkohshme ose objektet ekzistuese ne kete zone.
- Germimi dhe hapja e themeleve te objektit
- Betonimi i themeleve
- Ngritja e struktures prej betoni dhe hekuri (betoni blihet i gatshem nga prodhuesit)
- Punimet e mbuleses se objektit, solete beton arme, etj
- Muratura, suvatimet, instalimet inxhinierike per objektin e administrates etj.
- Sistemimi i shesheve te lira rreth objektit, rruget hyrese e dalese
- Rehabilitimi i hapesirave te gjelberta te projektuara, etj.

3.6. Lloji, volumi, konsumi dhe prodhimi i lëndëve të para

Lendet e para te perdorura do te jene kryesisht llaci i betonit i cili prodhohet nga kjo firme, hekuri dhe betoni per strukturen mbajtese te objektit, tulla dhe tjegulla per mbushjen e mureve dhe te mbuleses, material poliesteroli per izolim, rere dhe gelqere per suvatimin e mureve, dyer dhe dritare duralumini te gatshme dhe instalimet inxhinierike te brendshme.Persa shkruam me larte behet fjale per Objektet e ndryshme qe jane ndertuar ne kete kantjer me qellim te jene ne funksion te ketij aktiviteti. Objekti do te jete me destinacion prodhim te betonit. Shkarkimet e ujerave, do te lidhen me sistemin e kanalizimeve te zones, ku pas ndryshimeve te viteve te fundit, duhet te ndertohet nje rrjet i ri me kapacitete me te medha. Studimet duhet te hartohen per nje periudhe afatmesem dhe afatgjate.

3.7. Pershkrimi i mbuleses bimore

Siperfaqja eshte toke e llojit zallishte dhe truall, me bimesi barishtore dhe reliev te jo te pjerret. Nuk karakterizohet nga flore dhe faune me interes per komunitetin dhe institucionet e mbrojtjes se mjedisit.

3.8. Informacion për shkarkimet në mjedis.

Shkarkimet ne mjedis gjate fazes ndertimore do te jene kryesisht pluhurat nga punimet e ndertimit ne kantier (LNP), si dhe zhurmat ne mjediset e punes nga makinerite e punimeve te ndertimit. Ky efekt mund te transmetohet edhe ne mjediset e zones perreth nese nuk kryhet larja dhe pastrimi i mjeteve para daljes se tyre nga kantieri dhe lagia e siperfaqeve te pa shtruara gjate sezonit te thate. Keto ndikime do te jene te perkohshme dhe nuk do te kene

veti akumuluese ne mjedisin e zones. Mbetjet e ngurta nga faza ndertimore do te jene ambalazhe te produkteve te ndryshme te cilat jane te ricikluesshme dhe do te menaxhohen nga firma pastruese e territorit urban.

Ky process nuk perben problem serioz per zhvilluesit sot, megjithese ende nuk eshte percaktuar perfundimisht menyra e menaxhimit te tij. Aktualisht, subjektet private e transportojne ate per nje rruge te gjate deri ne periferi te qytetit, duke e shkarkuar ne zona te percaktuara nga komunat.

Ne sheshin e Fabrikes, prone private, nuk gjenden objekte egzistuese. Situara brenda sheshit nuk ka te beje fare me urbanistike, duke mos permbushur asnje kriter apo komoditet jetesor per pronaret e truallit. Per keto arsye, duke pare qe ne shesh nuk ka objekte te ndonje rendesie te veçante apo me vlera arkitektonike.

Ky investim do të jetë në funksion të përmirësimit të kushteve te punesimit ne zone.

4 PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

4.1. Te Pergjithshme

Zona e ku eshte ndertuar Fabrika se Betonit dhe perreth saj, karakterizohet si zone mesdhetare, me dimer te lagesht dhe te bute dhe vere te thate. Ne kete zone klima e mire eshte me e gjate se ne cdo territor te shqiperise.

Faktoret qe e percaktojne klimen e zones jane:

1. Afersia me detin, i cili siguron nje dimer te bute dhe vere te nxehte;
2. Influenca e cikloneve dhe anticikloneve, te cilat e rregullojne klimen ne te gjithe territorin;

4.2. Burimet ujore per zonen.

Si vend i Shqiperise se Jugut zona ne fjale perbehet nga lumi I Vjoses dhe Lumit Drino. Lumi Drino formohet nga bashkimi I disa perrenjeve dhe prroskave i cili eshte nje lum qe formohet nga bashkimi i disa lumenjve dhe perrenjve te zones dhe ne Juglindje dhe ne Jug te territorit te nga disa perrenj e lumenj te tjera locale.

4.3. Problemet kryesore te zones.

Pas viteve 90-te, nje migrim ne mase i popullsise nga zonat rurale drejt atyre urbane sollen ndikim te madh ne mjedis. Disa nga pasojat kryesore jane:

Pyjet- shkaterrimi i pyjeve nga prerjet ilegale dhe renia e zjarreve shkaktojne demtimin e ekuilibrit natyror dhe zhvillim te erozionit, sidomos pergjate bregdetit dhe ne skarpat e lumenjve. Shkalla e demtimit te pyjeve dhe kullotave eshte vleresuar me mijera hektar te shkaterruar. Burimet ujore dhe pyjet luajne nje rol te rendesishem ne zhvillimin social-ekonomik, ne mireqenie dhe ne shendetin publik.

Mbetje e ngurta: Te gjithe territoret e rajonit aplikojne grumbullim te mbetjeve te ngurta dhe riciklimin pjeserisht te ketyre mbetjeve, por jo te trajtohen. Ne keto kushte vleresohet

nevoja e nje landfill-i per te gjithe rajonin dhe duhet te aplikohet metoda e ndarjes se mbetjeve qe ne vendburim.

Ajri: Çlirimi i carbonit nga mjetet rrugore dhe industria duhet te kontrollohet dhe rregullohet ne baze mire percaktimin e kontrates, sepse ata jane burimet kryesore te ndotjes se ajrit. Perdorimi i mjeteve te vjetra si dhe i ndertimi i objekteve ndikojne ne rritjen e ekspozimit ne rrezik te shendetit publik.

Sektori i ndertimit: ka pasur nje bum ndertimesh se fundmi, te cilet jane bere shkaktaret kryesor te ndotjes se ajerit. Gjate ketyre viteve te fundit industria e ndertimeve ka pasur nje zhvillim te madhe te ndertimeve. Aktivitetet ndertuese ne shume raste kane ndikuar negativisht ne hapesirat e gjelberta.Mbejtet e ngurta (inerte) jane depozituar ne zona te pa pershtatshme.

Mungesa e hapesirave te gjelberta: Qyteti I Tepelenes ka hapesira te gjelberta,si dhe per raportin e numrit te popullsise ato jane te mjaftueshme per qytetin dhe rrethinat.

Uji dhe basenet ujore: bujqesia,blegtoria si dhe turizmi eshte prioritet i zhvillimit te zones dhe pjeserisht cilesia e ajerit dhe ujit te pijshem, ujerave siperfaqesor (ujerave te liqeneve) dhe burimet ujore jane te rendesishme po ashtu.

Nje analize e pergjithshme per zonat urbane dhe rurale:

Zona rurale: mungesa e disiplines ne shkarkimet e ujerave te zeza shoqerohet me mungese te pikave te percaktuara te shkarkimeve per familjaret dhe mbetjet e ndertimit dhe hyrja ne treg e paketimeve te materialeve ka nje ndikim te madhe ne flore dhe faune si dhe ne ndotjen e ujerave pranveror. Rrjedhja e nje sasie te madhe te ujit (perrenjve dhe ujerave te shiut) jane burimi kyesor i shpelarjes se siperfaqes se tokes te cilet marrin me vete dhe mbetje vajore (vajra lubrifikues apo hidrokarbure) te cilet jane derdhur pa kriter ne lumenjte e zones. Zona urbane:nuk jane te rrezikuara nga ndotja e ujerave te ndotura, si edhe lumenjve e perrenjve kryesore etj., si rezultat i shkarkimeve te kanalave te ujerave te zeza ne to ne menyre direkte pa iu nenshtruar me perpara nje trajtimi. Ne qytetin e Tepelenes, kryesisht ne zonen qendrore te qytetit por edhe ne rrethinat eshte kryer rehabilitmi i rrjetit te kanalizimeve Ndertimi i nje impianti per trajtimit bioorganik per ujerat e zeza eshte shume i domosdoshem ne rajonin ne fjale. *"Pikat e nxehta":* Zona nuk ka ndonje ndotje te trasheguar nga teknologjia e perdorur te Ish Fabrikave, ku zona e Minieres se Memaliajt eshte vleresuar si nje nga "pikat me te nxehta" te rajonit. Per te patur nje mbrotje te mjedisit dhe shendetit publik si dhe rritje te zhvillimit ekonomik te zones, rehabilitimi i pjeseve te kontaminuara duhet te jete nje nga prioritet kryesore qe kerkojne nje zgjidhje te menjehershme.

Te gjithe aktivitet qe do te operojne ne kete park energjitk do te jene nje rrisk i madh per mjedisin si dhe ne menyre qe te mbrojme mjedisin natyror dhe human, teknologjia e tyre duhet te jete konform standardeve te BE-se ne lidhje me ndotjen e ajerit, ujit dhe tokes.

Ndotja e mjedisit natyror eshte si rezultat i:

- Industrise se nxjerrjes se naftes si dhe te ujit qe perdoret per keto procese;
- Ndotja nga ujerat e zeza;
- Shfrytezimi i burimeve natyroe nga bizneset (si shtreterit e lumenjve, minerale, etj)
- Mbetje nga proceset industriale;
- Braktisja apo vendepozitimi i municioneve ushtarake qe kane dale jashte perdorimi;
- Mjetet rrugore si dhe pjese te tyre;
- Mbetje spitalore;
- Mbetje te ngurta (plastike, leter, etj)
- Mbetje pesticidesh.
- Uzinat e prodhimit te lendeve kimikate te abandonuara.

4.4. Mjedisi fizik

Gjeologjia, gjeomorfologjia

Shqiperia si formacion gjeologjik eshte pjese perberese e rrudhosjeve alpino-mesdhetare pjese e degezimit Dinaro-Albano-Helenid, ku ne bejme pjese tek Albanidet. Tirana ben pjese ne ultesiren Pran Ardiatike, qe shtrihet nga Velipoja deri ne Seman. Zhvillimi gjeologjik i territorit te Tiranes i perket Plioceni dhe Kuaternarit kur ultesira praneadriatike nisi te dale mbi uje si pjese e kontinentit. Deti u terhoq perfundimisht. Gjate kesaj periudhe ne Kuaternar kane ndodhur shume procese qe kane cuar ne formimin e strukturave antiklinale dhe sinklinale. Territori i Tiranes perbehet gjithashtu nga depozitime terrigjene (ranore, konglomerate, argjile, gelqeroresh etj. Ne territorin e zones ka dhe prurje aluvionale. Ne ndertimin e relievit te zones kane ndikuar edhe termetet. Pasoje e ketij ndertimi gjeologjik jane edhe pasurite nentokesore si qymyrguri etj.

Zona perreth zones ben pjese ne zonen tektonike Pran-Adriatike ku strukturat e ngritura antiklinale ne lindje te ketij sheshi ndertohen nga formacione Mollasike te Neogjenit.

Kushtet Gjeologo - Inxhinierike

Ne baze te karakteristikave fiziko - mekanike, perberjes litologjike, kushteve Gjeologo-Inxhinierike dhe kushteve te formimit ne sheshin e ndertimit, kemi veçuar 4 (kater) shtresa, te cilat po i trajtojme ne veçanti me poshte.Mbi keto shtresa gjeologjike eshte vendosur Fabrika e Asfaltit.

SHTRESA Nr.1

Toka vegjetale, te cilat perbehen nga surera dhe rera me ngjyre kafe ne bezhe me lageshtire, permbajne rrenje bimesh dhe jane pak te ngjeshura. Takohen nga siperfaqja deri ne thellesine 0.80 – 0.90m, (shiko prerje gjeologjike). Rekomandohet qe ne kete shtrese te mos mbeshteten themelet e objektit.

SHTRESA N.2

Perfaqesohet nga surera deri ne rera te imta pluhurore me ngjyre bezhe ne gri, jane te ngopura me uje, permbajne pak leshterike dhe lende organike. Jane pak deri ne mesatarisht te ngjeshura. Takohet ne thellesite: 1.0 m deri 4.0 m.
Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja *granulometrike*

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	9.60 %

Fraksioni pluhuror	0.002-0.05 mm	28.60%
Fraksioni rere	> 0.05 mm	61.80 %
Fraksioni zhavorr	> 2.00 mm	0.00 %
Lageshtia natyrore		Wn = 26.90 %
Pesha specifike		$\delta = 2.70$ T/m^3
Pesha volumore ne gjendje natyrale		$\Delta = 1.95$ T/m^3
Koeficienti i porozitetit		$\varepsilon = 0.74$
Moduli i kompresionit		E = 70 kg/cm^2
Kendi i ferkimit te brendshem		$\varphi = 28^o$
Kohezioni		C = 0.08 kg/cm^2
Forca e ferkimit pilote-toke		F_f =2.2 T/m^2
Ngarkesa e lejuar ne shtypje		σ = 1.6 kg/cm^2

SHTRESA N.3

Perfaqesohet nga eluvion i formacionit rrenjesor, argjilite dhe alevrolite intensivisht te perajruara me ngjyre bezhe ne gri, me cimentim te dobet deri mesatar. Jane te ngjeshura. Takohet ne thellesite: 4.0 m deri 8.5m. Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja *granulometrike*

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	27.00 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.05 mm	34.20%
Fraksioni rere	> 0.05 mm	38.80 %
Lageshtia natyrore		Wn =17.20%
Kufiri i siperm i Plasticitetit		Wrr =46.77%
Kufiri i poshtem i Plasticitetit		Wp =28.54%
Numri i Plasticitetit		F =18.44
Pesha specifike		$\delta = 2.69$ T/m^3
Pesha volumore ne gjendje natyrale		$\Delta = 2.12$ T/m^3
Koeficienti i porozitetit		$\varepsilon = 0.50$
Moduli i kompresionit		E = 440 kg/cm^2
Kendi i ferkimit te brendshem		$\varphi = 28^o$
Kohezioni		C = 0.60 kg/cm^2

Forca e ferkimit pilote-toke	F_f =2.8 T/m^2
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	σ = 2.10 kg/cm^2
Rezistenca ne shtypje nje boshtore	Rc =18 kg/cm^2

SHTRESA Nr.4

Perfaqesohet nga argjilite ranore dhe alevrolite me ngjyre gri me cimentim mesatar. Jane me carje. Jane te ngjeshura. Takohet ne thellesite: 8.50 m deri 12.50 m.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja *granulometrike*

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	9.50%
Fraksioni pluhuror	0.002-0.05 mm	35.50%
Fraksioni rere	> 0.05 mm	55.00 %
Lageshtia natyrore		Wn =22.52%
Pesha specifike		δ = 2.67 T/m^3
Pesha volumore ne gjendje natyrale		Δ = 2.32 T/m^3
Pesha e volumit te skeletit		γ = 1.70 T/m^3
Koeficienti i porozitetit		ε = 0.38
Moduli i kompresionit		E = 840 kg/cm^2
Kendi i ferkimit te brendshem		φ = 28^o
Kohezioni		C = 0.74 kg/cm^2
Ngarkesa e lejuar ne shtypje		σ = 2.70 kg/cm^2
Rezistenca ne shtypje nje boshtore		Rc =25 kg/cm^2

7.0 Perfundime Dhe Rekomandime te Studimit Gjeologjik

Ne sheshin e ndertimit takohen depozitimet te kuaternarit Q4 dt qe perfaqesohen nga surera, rera dhe argjila lymore. Jane pak deri mesatarisht te ngjeshura. Keto depozitime takohen ne zonen fushore dhe depozitimet dhe depozitimet neogjenike ne zonen kodrinore te cilat jane te mbuluara nga depozitime deluvialo eluviale.

Niveli i ujit nentokesor eshte rreth 3.00 m nga siperfaqja e tokes. Jane ujra te neutral, deri pak te kripura, per kete duhet te tregohet kujdes nga projektuesiper mbrojtjen e themeleve nga korrozioni i kripes. Jane ujera agresive kundrejt hekurit dhe betonit.

Dukuri negative fiziko - gjeologjike ne sheshin e studjuar nuk jane konstatuar, por ne qoftese nuk merren masa inxhinierike per mbrojtjen e skarpatave rrezikohen faqet e gropes gjate punimeve per realizimin e themelit.

Rekomandojme qe ne Shtresen Nr. 1 te mos mbeshteten themele te objektit. Optimale eshte te mbeshteten ne te gjitha shtresat e tjera, ne Shtresen Nr. 2, shtresa Nr.3 dhe shtresa Nr.4.

Per çdo konsultim qe do te kete nevoje investitori autoret e studimit jane te gatshem deri ne perfundimin e projektit dhe ne ndertimin e themeleve.

Te tregohet vemendje per te ruajtur qendrueshmerine e gropes se hapur per inkastrimin e themeleve te godines, sepse faqet e gropes jane te pa qendrueshme prandaj te meren masa mbrojtese inxhinierike.

Intensiteti sizmik I pritshem sipas Kodit te Aprovuar ne Republiken e Shqiperise eshte 8 Balle MSK 64. Rekomandojme qe para betonimit te themeleve ne bazamentin natyral te vendoset nje shtrese zhavori me trashesi 30 – 40cm.Te tregohet vemendje gjate thithjes se ujrave nentokesore per te mos thithur se bashku me ujin dhe grimcat e imta. Per te evituar kete fenomen rekomandojme qe uji te thithet ne rrjedhje te lire pa krijuar rryma turbulente.

Sizmiciteti.

